

TË DHËNA FAKTIKE LIGJET & RREGULLORET

SEKRETARIATI I



LIGJET NË SHËRBIM TË BIZNESEVE, MIRATIMI I TYRE, PROGRAMI LEGJISLATIV, DHE STATUSI I LIGJEVE.

Sekretariati i KKEI-së ka përcjellë ecurinë e miratimit të projektligjeve, të parapara në programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2021. Këto projektligje ndërlidhen me veprimtarinë e sektorit privat në Kosovë. Sekretariati ka krahasuar progresin e bërë nga Qeveria lidhur me miratimin e projektligjeve dhe afateve të përcaktuara në programin legjislativ për miratimin e tyre.

Më poshtë mund të gjeni listën e projektligjeve dhe ecurinë e miratimit të tyre nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sekretariati ka përgatitur listën e këtyre projektligjeve dhe ministrive përgjegjëse që sponsorizojnë këto projektligje

MINISTRIA E EKONOMISË

Ligji për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionin Elektronike i cili rregullon mënyrën e identifikimit dhe skemat e identifikimit elektronik; kushtet e përdorimit të nënshkrimit elektronik, vulës elektronike të kohës dhe pajisjeve për krijimin e tyre; shërbimet e transmetimit të rekomanduara për transaksione juridike, procese gjyqësore dhe procedura të tjera; kushtet e lëshimit dhe përdorimit të certifikatave të kualifikuara për certifikimin e shërbimeve dhe vërtetimin e faqes në internet, shërbimet e besuara në transaksionet elektronike dhe dokumentet elektronike.

Ligji zbatohet për skemat e identifikimit elektronik dhe për ofruesit e besueshëm të shërbimeve në transaksionet elektronike. Ligji është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 6 dhjetor 2021.-Ligji për Ndërmarrjet Publike, fillimisht është planifikuar të miratohet nga Qeveria më 30 nëntor 2021, por është tërhequr më pas nga programi legjislativ bazuar në vendimin nr. 02/31 të nxjerrë nga Qeveria më 25 gusht 2021.

Hartimi i Strategjisë së Energjisë 2022-2030, e cila mund të përfshijë rekomandimet e sektorit privat si më poshtë

REKOMANDIMET E SEKTORIT PRIVAT

Dixhitalizimi i të gjitha proceseve institucionale në Kosovë, duke shfrytëzuar ekskluzivisht shërbimet e sektorit të TI-së në Kosovë.

Krijimi i instrumenteve financiare për financimin e tranzicionit në energji

Diversifikimi i infrastrukturës energjetike dhe mbështetja e diversifikimit të burimeve të energjisë.

MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE

Projektligji i Punës, i cili do rregullonte të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës. Ky projektligj është paraparë të miratohet nga Qeveria më 30 qershor 2022.

Projektligji për Partneritetin Publiko Privat, i cili përcakton kuadrin ligjor të PPP-ve duke paraparë kushtet, parimet, kriteret dhe procedurat për hyrjen në PPP, përmbajtjen dhe strukturën e marrëveshjeve PPP si dhe strukturën institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e PPP-ve në Republikën e Kosovës. Ky projektligj është paraparë të miratohet nga Qeveria më 15 mars 2022.

Projektligji për bankat, i cili promovojnë dhe mbajnë një sistem financiar të qëndrueshëm duke nxitur menaxhimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm të bankave. Ky projektligj do të zbatohet për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, aksionarët e tyre, bordin e drejtorëve dhe drejtuesit e lartë, punonjësit, agjentët dhe filialet e tyre. Ky projektligj është paraparë të miratohet nga Qeveria më 30 shtator 2022.

Projektligji për Institucionet Mikro-financiare dhe institucionet financiare jo Bankare për rregullimin e licencimit, funksionimit dhe mbikëqyrjes së Institucioneve Mikro-financiare dhe institucioneve financiare jo Bankare. Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari financiare mikrofinanciare dhe jo bankare në Republikën e Kosovës. o. Ky projektligj është paraparë të miratohet nga Qeveria më 25 gusht 2022.

Projektligji për Prokurimin Publik, që ofron mënyrën më efikase, transparente dhe të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike dhe të gjitha mjeteve dhe burimeve tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat për t'u respektuar dhe detyrimet që duhet të përmbushin

personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuale, koncesionarët e punës dhe organet publike që zhvillojnë, janë të përfshirë, marrin pjesë ose janë të interesuar në aktivitete prokurimi ose që janë të përfshirë ose të lidhur me fonde dhe/ose burime të tilla.. Ky projektligj është paraparë të miratohet nga Qeveria më 20 qershor 2022.

Projektligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat i cili rregullon procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore në Republikën e Kosovës, si dhe parimet e organizimit dhe funksionimit të ATK-së.. Ky projektligj është paraparë të miratohet nga Qeveria më 15 shtator 2022..

Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar që rregullon sistemin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në territorin e Republikës së Kosovës. Ky projektligj ishte planifikuar të miratohej nga Qeveria më 27 dhjetor 2021, por në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 02/42 datë 27 tetor 2021, i njëjti projektligj është tërhequr nga programi legjislativ..

Kodi doganor dhe i akcizës i cili rregullon elementet bazë të sistemit për mbrojtjen doganore të ekonomisë së Kosovës dhe të drejtat dhe detyrimet e të gjithë pjesëmarrësve në zbatimin e legjislacionit doganor. Ky projektligj është planifikuar të miratohet në Qeveri më 15 qershor 2022..

Projektligji për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore që lehtëson qasjen në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme duke ofruar garanci kredie për institucionet financiare të regjistruara. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës..

REKOMANDIMET E SEKTORIT PRIVAT

- Miratimi i Ligjit të Lehonisë dhe pushimit prindëror.
- Miratimi i Ligjit të ri të Punës.
- Trajtimi i humbjes së peshës së mallrave si pasojë e avullimit.

Sa i përket humbjes së peshës së mallrave si pasojë e avullimit, Sekretariati i KKEI-së:

Inicoi dhe organizoi një takim të grupit të punës për trajtimin e humbjes së peshës së produkteve për shkak të avullimit. Ky grup punues ishte i përbërë nga: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës.

Nisi një analizë krahasimore për trajtimin e humbjes së peshës së produkteve për shkak të avullimit, për t'i ofruar grupit punues një raport analizues për rregullimin e kësaj çështje në vendet e rajonit..

MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

Projektligji për Zonat Ekonomike i cili përmban dispozita për themelimin e zonave ekonomike, zonave të lira ekonomike, krijimit të bazës për hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike, vendndodhjen, mënyrën e shfrytëzimit dhe promovimin e zonave ekonomike dhe formimin e këshillit kombëtar për zonat ekonomike. Përcakton të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesve, përdoruesve/operatorëve dhe subjekteve të tjera që ushtrojnë veprimtari në lidhje me zonat ekonomike, llojin e veprimtarive që kryhen brenda zonave ekonomike, mënyrën e lëvizjes së mallrave nëpër to, si dhe lehtësitë fiskale të paraparë. Ky projektligj është paraparë të miratohet nga Qeveria më 01 mars 2022.

Projektligji për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, i cili rregullon promovimin dhe mbrojtjen e investimeve, përcakton prioritetet dhe lehtësirat për investime, shpalljen dhe realizimin e investimeve strategjike, organet kompetente për investime, si dhe procedurat e kujdesit ndaj investitorëve. Përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve publike, investitorëve dhe organizatave tjera që kanë të bëjnë me investimet në Republikën e Kosovës. Ky projektligj ka hyrë në program legjislativ me Vendimin e Qeverisë nr. 02/45 i lëshuar më 24 nëntor 2021 dhe është planifikuar të miratohet deri më 23 mars 2022.

Projektligji për Inspektimet, i cili përcakton kornizën e nevojshme ligjore për zbatimin e reformës së sistemit të inspektimit në Republikën e Kosovës. Përcakton racionalizimin e numrit të organeve inspektuese në administratën shtetërore, qartësimin e kompetencave të tyre përkatëse, përmirësimin e procedurave të koordinimit dhe riorganizimit si dhe kërkesave për kryerjen e inspektimeve nga organet inspektuese në administratën shtetërore dhe në nivel komunal. Ky ligj parashikon parimet e inspektimit, rregullat për organizimin e organeve inspektuese në kompetencë të administratës shtetërore dhe bashkive, rregullat për bashkërendimin e veprimtarive inspektuese dhe procedurën e inspektimit.

Ky ligj do të zbatohet edhe për të gjitha funksionet inspektuese në kompetencë të administratës shtetërore dhe komunave në Republikën e Kosovës, përveç: Inspektimit Doganor dhe Tatimor; Inspektimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; dhe Inspektimet e brendshme me karakter administrativ në Administratën Shtetërore dhe Komunale.. Ky projektligj është miratuar nga Qeveria dhe rrjedhimisht e ka proceduar më tej për shqyrtim në Kuvend më 17 dhjetor 2021. Kuvendi e ka miratuar projektligjin më 23 dhjetor 2021.

Projektligji për tregtinë e jashtme, i cili rregullon tregtinë e jashtme në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, duke mbrojtur prodhuesit vendas nga praktikën e padrejta të tregtisë ndërkombëtare dhe duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies së popullatës së Kosovës. Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme që rregullojnë importimin, eksportimin dhe transitin e mallrave dhe shërbimeve për dhe nga territori i Kosovës. Kuvendi i Kosovës miratoi projektligjin në shkurt 2022.

Projektligji për Tregtinë e Brendshme ishte planifikuar të miratohej më 15 nëntor 2021, por në bazë të vendimit të Qeverisë nr. 02/42 datë 27 tetor 2021, i njëjti projektligj është tërhequr nga programi legjislativ.

Projektligji për Mbrojtjen e Konkurrencës i cili përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat, organizimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës si dhe procedurat për zbatimin e këtij ligji. Projektligji zbatohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës nga ndërmarrjet në territorin e Kosovës apo jashtë saj nëse këto veprime kanë efekt në tregun kosovar. Projektligji ishte planifikuar të miratohej më 15 korrik 2021. Ai u miratua dhe aktualisht është në diskutim publik në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

MINISTRIA E DREJTËSISË

Projektligji për Gjykatën Komerciale që rregullon themelimin, organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Komerciale në Kosovë. Ky ligj vlen për të gjithë personat juridikë dhe fizikë, duke përfshirë edhe kompanitë e përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës që kanë konteste komerciale ndërmjet tyre. Kuvendi i Kosovës miratoi projektligjin në parim dhe pritet të miratohet plotësisht nga Kuvendi në janar të vitit 2022.

REGJIMI I FALIMENTIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Ligji për Falimentimin është miratuar më 9 qershor 2016 dhe është shpallur me Dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës më 23 qershor 2016 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare më 7 korrik 2016.

Ky ligj aplikohet ndaj të gjitha shoqërive tregtare. Nuk aplikohet ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës; njërive qeveritare; institucioneve financiare si bankat, institucioneve mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare; kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësimit; fondeve pensionale ose ofruesve të skemave pensionale të licencuara dhe të rregulluara nga BQK-ja; ndërmarrjeve shoqërore dhe publike.

GJYKATA KOMPETENTE PËR PROCEDURËN E FALIMENTIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Gjykata kompetente për procedurën e falimentimit në Kosovë është Gjykata Themelore e Prishtinës – Departamenti për Çështje Ekonomike (Gjykata kompetente do të jetë Gjykata Komerciale pas miratimit të ligjit të saj nga Kuvendi i Kosovës).

FILLIMI I PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Ligji për falimentimin përcakton procedurën e falimentimit vullnetar dhe të detyrueshëm.

Procedimi vullnetar i falimentimit fillon nga debitori, duke paraqitur kërkesën për riorganizim ose likuidim. Procedimi i detyrueshëm mund të fillohet nga dy ose më shumë kreditorë, duke paraqitur një kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit ndaj debitorit. Në mënyrë që kreditori të ketë të drejtë të kërkojë fillimin e procedurës së falimentimit, borxhi i debitorit ndaj secilit kreditor duhet të jetë së paku 3,000.00 €, ai duhet të ketë afat të paktën 90 ditë dhe nëse debitori nuk po i paguan borxhet e veta të papaguara dhe totali i borxheve të papaguara tejkaloi 5,000.00€.

Vëmë re se fillimi i procedurës së falimentimit duhet të jetë i thjeshtë. Ligji i ri për Falimentimin duhet të thjeshtojë fillimin e procedurës së falimentimit. Procedimi i detyrueshëm, siç u përmend më lart, mund të fillojë nga dy ose më shumë kreditorë, duke paraqitur një kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit ndaj debitorit. Kjo kërkesë është shumë e vështirë për t'u përmbushur, pasi është e vështirë të bësh dy kreditorë që të paraqesin njëkohësisht një kërkesë për të filluar procedurën e falimentimit kundër një debitori.

Ligji mund t'u ofrojë kreditorëve mundësinë që individualisht të iniciojnë fillimin e një çështjeje falimentimi të detyrueshëm.

PROCEDURAT E FALIMENTIMIT

- Procedura e Riorganizimit
- Procedura e Likuidimit

PROCEDURA E RIORGANIZIMIT

Procedura e riorganizimit synon të rivendosë stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë e biznesit të një debitori, të ruajë vendet e punës dhe biznesi të vazhdojë të funksionojë. Në bazë të nenit 3 paragrafi 1.38 të Ligjit për Falimentimin, riorganizimi përkufizohet si proces me të cilin mund të rikthehet mirëqenia financiare dhe qëndrueshmëria e biznesit të debitorit. Mund të pasqyrohet në shumë forma si falja, ri-programimi i borxhit, konvertimet e kapitalit të borxhit dhe shitja e pjesëve të biznesit të tij si vazhdimësi.

Kur hapet rasti pasojat janë si më poshtë: krijohet pasuria e falimentimit, gjykata fiton juridiksionin ekskluziv mbi masën e falimentimit dhe mbi debitorin; bëhet pezullimi i procedurës; në rastin e riorganizimit në të cilin nuk kërkohet një administrator, debitorit i jepen kompetencat dhe detyrat e “debitorit në posedim”; dhe në një rast riorganizimi në të cilin kërkohet një administrator, debitori hiqet nga kontrolli mbi asetet e tij dhe administratorit i jepet kontrolli i tillë. Në procedurën e riorganizimit, debitori është përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit. Në rastet kur gjykata cakton një administrator falimentimi, përfaqësues do të jetë administratori. Procedura e riorganizimit mbron ndërmarrjet në falimentim nga hyrja në likuidim/shitja e aseteve për të paguar kreditorët dhe për rrjedhojë shpëtimin e veprimtarisë së biznesit.

Bizneset në paaftësi për të shlyer detyrimet, mund ta konsiderojnë riorganizimin e tyre si një mundësi riorganizimi të borxhit (rinegociim i kushteve kontraktuale me kreditorët) për të ruajtur pronësinë e aseteve të tyre dhe për të vazhduar aktivitetin e tyre gjatë riorganizimit. .

PROCEDURA E RIORGANIZIMIT TË NVM-VE

Ligji përcakton që rasti i falimentimi kur përfshihen NVM-të si debitor, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, duhet të trajtohet si rast riorganizimi. Theksojmë se ky ligj jep një trajtim të veçantë për NVM-të, ku sa herë që një rast ka të bëjë me një debitor NVM do të trajtohet si rast riorganizimi. Kjo mbron NVM-të nga likuidimi dhe procesi i shitjes së aseteve për të paguar kreditorët.

FALIMENTIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Ekziston një numër i vogël i rasteve të falimentimit të parashtruara në Gjykatën Themelore të Prishtinës - Departamenti për Çështje Ekonomike. Sipas informacioneve të marra nga e njëjta gjykatë, është një numër i vogël i çështjeve të falimentimit të nisura dhe administruara nga gjykata. Për periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2021 janë gjithsej 12 raste. Ndërsa për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2021 janë gjithsej 21 raste. Kjo mund të ndodhë për faktin se falimentimi është i ri në Kosovë dhe nuk përdoret nga bizneset.

REGJISTRI I FALIMENTIMIT

Nuk ekziston një regjistër falimentimi publikisht i disponuar. Mungesa e një regjistri të tillë, i pengon bizneset të marrin informacion të detajuar për partnerët potencialë të biznesit.

FALIMENTIMI NDËRKOMBËTAR

Ligji parasheh falimentimin ndërkombëtar duke përcaktuar ndihmën e gjykatës ose administratorit që i jepet një përfaqësuesi të huaj, të drejtat e kreditorëve ndërkombëtarë të qasen në procedurën e falimentimit, njohjen e procedurës së huaj nga gjykata në Kosovë dhe bashkëpunimin ndërmjet përfaqësuesit të pasurisë së falimentimit në Kosova me gjykata apo përfaqësues të huaj.

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Projektligji për Pasurimin e Miellit, i cili përcakton rregullat që zbatohen për pasurimin e miellit për konsum, si një nga mënyrat që synon parandalimin dhe reduktimin e sëmundjeve të shkaktuara nga mungesa e hekurit dhe acidit folik. Zbatohet me qëllim të përcaktimit të bazës ligjore për rregullimin dhe sigurimin e popullatës të Kosovës me miell të pasuruar me hekur dhe acid folik në mënyrë të detyrueshme dhe sipas statusit ushqyes dhe në baza vullnetare edhe me vitamina A, B12 dhe zink. Qeveria e Kosovës miratoi

REKOMANDIMET E SEKTORIT PRIVAT

Heqja e kontradiktës ndërmjet Ligjit për Minierat dhe Udhëzimit Administrativ nr. 10/2010 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Sa i përket rekomandimit të sektorit privat, ka kontradiktë ndërmjet nenit 21 dhe 30 të Ligjit për Miniera dhe Minerale dhe nenit 4 paragrafi 13.8 i Udhëzimit Administrativ nr. 10/2010 për Ndërrimin e Destinimit të tokës bujqësore i ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2020, në lidhje me sipërfaqen e tokës bujqësore të përdorur për aktivitete minerare. Ligji për Minierat i ndryshuar, respektivisht neni 21 paragrafi 1 nën-paragrafi 2 parasheh që “Licenca e Hulumtimit për Minerale Ndërtimore... vlen për një zonë që nuk është më e madhe se 50 hektarë”, ndërsa Udhëzimi Administrativ nr. 01/2020 për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 10/2010, dhe 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, përkatësisht neni 4 paragrafi 13.8 parasheh se “...e drejta e përdorimit të tokës bujqësore mund të jepet për sipërfaqe deri në 20 hektarë”.

Po ashtu, sipas këtij rekomandimi, kufizimet e sipërfaqes për ndryshimin e përdorimit të tokës bujqësore, të parapara në nenin 4 paragrafi 13.8 të Udhëzimit Administrativ të lartpërmendur, jo vetëm që nuk kanë bazë ligjore në Ligjin për Bujqësi, por janë në kundërshtim me nenet 21 dhe 30 të Ligjit për miniera dhe minerale dhe nenin 4 paragrafi 13.7 dhe 13.8 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Nga sa u tha më sipër, kufizimet e sipërfaqes për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të parapara me nenin 4 paragrafi 13.8 të Udhëzimit Administrativ, janë zëvendësuar me kufizimin e sipërfaqes dhe mungesën e tij, për qëllime kërkimi dhe shfrytëzimi. të parapara sipas neneve 21 dhe 30 të Ligjit për Miniera dhe Minerale.

PËRGATITUR NGA DEPARTAMENTI LIGJOR I SEKRETARIATIT TË
KËSHILLIT KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME

SEKRETARIATI I



Mbështetur nga



European Bank
for Reconstruction and Development

Janar, 2022



Ministria e Ekonomisë, Sheshi "Zahir Pajaziti", (ish ndërtesa e Toskanës) 10000
Prishtinë



+383 38 200 215 53



info@nced-ks.com



www.ncei-ks.com

